

Prindër, roli juaj në orientimin e fëmijës tuaj



Departamenti i formimit, rinisë dhe kulturës
Shërbimi i arsimit të specializuar dhe të mbështetjes në formim
Zyra kantonale e orientimit shkollor dhe profesional


gusht 2016

Pas dy vjetësh fëmija juaj do të dalë nga arsimit të detyrueshëm për të hyrë në formimin profesional ose në gjimnaz.

Ju që i njihni mirë interesat e tij, cilësitë dhe pikat e forta të tij, mund t'a shoqëroni në kërkimin e një zanati apo një formimi, me mbështetjen e shkollës dhe të orientimit.

Gjatë muajve të ardhshëm, fëmija juaj do të informohet për zanatet dhe do të zbulojë botën profesionale. Ju mund t'a inkurajoni në kërkimet dhe në përçapjet e tij, duke ndarë me të pikëpyetjet dhe mendimet.

Në momentin e hartimit të projektit të tij të formimit, mbështetja juaj do të jetë gjithashtu e dobishme për të. Një projekt realist ka të bëjë me shumë faktorë që lidhen me personalitetin e fëmijës tuaj, me zanatin e synuar dhe me kërkesat e formimeve apo të tregut të punës.



Një zgjedhje për jetën?

Shijet dhe interesat ndryshojnë në rrjedhën e jetës; Për më tepër, shoqëria njih përparime të përherëshme në të gjitha fushat dhe profesione të reja lindin rregullisht. Në fund, sistemi i formimit zviceran karakterizohet nga një përshkueshmëri e madhe midis drejtimeve. Një formim i fuqishëm fillestar është në të gjitha rastet një trompolinë drejt evoluimeve të ardhshme.

Përçapja e orientimit mund të marrë kohë. Me ndihmën tuaj, ajo do të lehtësohet.

Për t'u informuar

Shoqëroni fëmijën tuaj në zbulimin e zanateve dhe institucioneve të formimit:

Broshurë

Formimi pas arsimit të detyrueshëm në Kantonin e Vaudit

Internet

www.vd.ch/orientation

Sit mobil

m.vd.ch/metiers

CIEP

Dokumentim me qasje të lirë në Qendrat rajonale të orientimit

Info-métiers

Me regjistrim, takime me profesionistë

Salloni i zanateve

Hyrje e lirë, çdo vit në vjeshtë

Për t'u njohur

Ju i dini mirë interesat e fëmijës tuaj, e njihni personalitetin e tij, anët e mira dhe motivimin e tij. Ju mund të diskutoni me të për këto dhe t'a ndihmoni që t'i nxjerrë ato në pah.

Për t'u orientuar

Flisni me fëmijën për përvojën tuaj në botën e punës, mbështeteni atë në realizimin e projektit të tij të formimit.

- Duke kërkuar ndihmë nga të afërmit, kolegët dhe të njohurit. Ndoshita ka ndonjë stazh apo vend si nxënës.
- Duke krijuar dosjen e kandidaturës.
- Duke ushtruar me të bisedën e punësimit.
- Duke përgatitur për kërkesat e formimit e të zanatit të zgjedhur.

Në të gjitha këto etapa, ju dhe fëmija juaj mund të keni mbështetjen e shkollës dhe të orientimit.

Në institucionin shkollor, psikologë dhe këshilltarë në fushën e orientimit ju presin me kërkesën tuaj. Bisedat janë falas.

10 S - EKPLORIM DHE INFORMIM

GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR Salloni i zanateve dhe formimit Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers
DHJETOR	JANAR	SHKURT	MARS
Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers	Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers	Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers	
PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK

11 S - ZGJEDHJE DHE REALIZIME

GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR Salloni i zanateve dhe formimit Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers
DHJETOR	JANAR	SHKURT	MARS
Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers	Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers Regjistrimi dhe provimet e pranimit Regjistrimi në gjimnaz Regjistrimi në rac I dhe II	Dyert e hapura të shkollave Info-Métiers Nata e nxënësisë Regjistrimi dhe provimet e pranimit	Regjistrimi dhe provimet e pranimit Kërkesë pranimi T1
PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK

Shkolla dhe orientimi me mbështetje

VG

Nxënësit e drejtimit të përgjithshëm zbulojnë një degë të re : qasja e botës profesionale (AMP). Materiali i hartuar nga Zyra kantonale e orientimit shkollor dhe profesional do t'i ndihmojë ata për të zbuluar zanatet dhe formimet, dhe për t'i njohur më mirë ato. Ata do të mësojnë gjithashtu si të formulojnë një letër motivimi dhe një CV të efektshme, dhe si të kandidojnë për zanatin e zgjedhur prej tyre.

VP

Nxënësit e degës parajimnaziale mund të regjistrohen në atelie orientimi të drejtuara nga psikologë këshilltarë/e në fushën e orientimit (COSP) të institucionit të tyre për të zbuluar rrugët e formimit dhe perspektivat e tyre.

Dokumentacioni që u jepet në klasë nxënësve të VG-së është gjithashtu në dispozicion të nxënësve të VP-së në linjë (www.vd.ch/orientation) ose në Qendrën e informimit mbi studimet dhe profesionet (CIEP) e rajonit të tyre.

Takimet e fëmijës tuaj

Ju mund ta shoqëroni fëmijën tuaj në shumicën e veprimtarive të organizuara në favor të orientimit, të shënuara me gërma të trasha në kalendar.

Shumë takime do të kryhen gjatë dy vjetëve të ardhshme. Ja një përzgjedhje takimesh që ju mund t'i shënoni më sipër.

- Atelie orientimi në shkollë, me regjistrim (VP).
- Bisedë me COSP-në, me takim.
- Vizitë në Qendrën e informimit mbi studimet dhe profesionet (CIEP) të rajonit tuaj, qasje e lirë.
- Stazh në ndërmarrje ose në Shkollën e zanateve.
- Test i aftësive me synim një formim profesional
- Bisedë punësimi.